



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), të nenit 20, paragrafit 3, nënparagrafi 3.1 i Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.12.2016, mori këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës, pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika:
  1. Pjesët e parcelave kadastrale nr. 494 dhe 495, Zona kadastrale Nëntë Jugoviq, në sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup>;
  2. Ndërtesa nr. O-71914021-00495-4-507-0, sipërfaqe të përgjithshme 257 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Nëntë Jugoviq;
  3. Ndërtesa nr. O-71914021-00495-4-230-0, sipërfaqe të përgjithshme 465 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Nëntë Jugoviq.
- III. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është në periudhë afatshkurtër për 15 vjet.
- IV. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- V. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VI. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

**VIII.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.

**IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 046-295921, më 06.12.2016**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Halim Halimi, jur. i dpl.**